

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit Rr. P., nga fshati D., Komuna e P., për shkak të veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë ii pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.374/2014 të datës 25.03.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Zejnullah Gashi, të akuzuarit, me date 09.02.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

RR. P., nga i ati J. dhe nëna E. e lindur R., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin D., Komuna e P., ku edhe tani jeton, ka të kryer fakultetin juridik, prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 pika 1.1. të KPP-ës,

REFUZOHET AKUZA

Me datë 29.03.2013, në kohë të papërcaktuar në Agjensionin kundër korrupsionit në Prishtinë, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, në formularin për deklarimin e pasurisë DRV 00207 – 2012/1, i cili sipas Ligjit nr.04/L-50, është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, në atë mënyrë që i pandehuri nuk paraqet saktë të hyrat vjetore të kërkuara në deklaratë, ekziston mos përputhje në mes të hyrave vjetore prej 11.158,06 eurove (njëmbëdhjetëmijënjëqindpesëdhjetetë euro e gjashtë cent) të deklaruara në formularin për deklarimin e pasurisë të paraqitur në vitin 2013 si dhe raportit nga të hyrat vjetore prej 22.158,06 Euro (njëzetedymijë e njëqindpesëdhjetetë euro e gjashtë cent), të siguruar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ku ndryshimi apo diferenca mes këtyre të hyrave është 11.158,06 euro ((njëmbëdhjetëmijënjëqindpesëdhjetetë euro e gjashtë cent), me ç’ rast i pandehuri në formular nuk i ka deklaruar saktë të hyrat vjetore,

Kësodore kishte për të kryer veprën penale mos raportimi ose raportimi i rremë ii pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KP-ës.

Për shkak se prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, është tërhequr nga akuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.374/2014 të datës 25.03.2014, kundër të akuzuarit Rr. P., nga fshati D., Komuna e P., për shkak të veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë ii pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Zejnullah Gashi, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: tërhiqemi nga ndjekja e mëtutjeshme penale ndaj të akuzuarit Rr. P., për shkak të veprës penale mos raportimi ose raporti i rremë i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare sipas nenit 437 par.2 të Kodit Penal Kosovës, pasi që gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave nuk është vërtetuar me asnjë fakt se këtu i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet. Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejt për drejt që përfshinë dijen e kryesit se ai i ka për detyrim ta deklaroj pasurinë në agjencionin anti korrupsion, por nuk dëshiron ta bëjë atë, pastaj dijen e tij se ai nuk i deklaron të gjitha të dhënat e nevojshme, pra do me thënë se kjo vepër penale konsumohet vetëm atëherë kur vërtetohet se kryesi nuk i ka përmbushur me dashje detyrimet ligjore për deklarimin e pasurisë, apo i ka falsifikuar me qëllim që të dhënat e paraqitura, përkatësisht nuk i ka paraqitur të dhënat e nevojshme.

Po ashtu konform dispozitave të ligjit nr.04/L-050 agjencioni antikorrupsion ka pasur për obligim që ta njofton deklaruesin që ka paraqitur këto deklarime në afatin prej 15 ditësh nga marrja e njoftimit, është i detyruar që pas këtij njoftimi ti përmirësoj, pastaj konform dispozitave të ligjit nr. 04/L-228, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të lartë cekur i shpallur me dekretin DL-013-214 të datës 07.04.2014 të dekretuar nga presidenca e Kosovës, e në rastin konkret agjencioni asnjëherë nuk e ka lajmëruar të pandehurin ose personin referues pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë ku ka punuar dhe ku ende punon i pandehuri, në lidhje me mos paraqitjen e pagesë shtesë.

Po ashtu konform natyrës të këtyre veprave penale i referohem aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër PML.nr.296/2016 të datës 18.01.2017 me të cilin në arsyetimin e këtij aktgjykimi konfirmohet se kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejt për drejt, sepse me dispozitën e nenit 437 të KP-ës nuk parashihet mundësia e kryerjes të kësaj vepre nga pakujdesia.

Andaj duke u bazuar nga të cekurat e më sipërme, vijmë në përfundimin e qartë se nuk janë përmbushur elementet e veprës penale si në dispozitiv të aktakuzës andaj tërhiqemi nga ndjekja e mëtutjeshme penale konform dispozitave të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1998/2015 të datës 09.02.2017

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.